



Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës,

Në mbështetje të nenit 21.2 dhe nenit 79 të Ligjit Nr.03/L-051 për Aviacionin Civil,

Duke pasur parasysh Rregulloren Nr. 4/2008 të Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës, të nxjerrur më 29 dhjetor 2008, e cila zbaton Direktivën 2006/23/EC të 5 prillit 2006, mbi Licencën e Komunitetit të Kontrollorit të Trafikut Ajror, (më tej referuar si "Direktiva"),

Me qëllim të përputhjes së plotë të Rregullores Nr. 4/2008 me Direktivën,

Nxjerr këtë:

**RREGULLORE Nr. 13/ 2010 QË AMANDAMENTON RREGULLOREN Nr. 4/2008
TË 29 DHJETORIT 2008 MBI LICENCËN E KONTROLLORIT TË TRAFIKUT
AJROR**

Neni 1

Neni 4, amendamentohet si në vijim:

Paragrafi 9, zëvendësohet me:

"Miratimet e gradimit dhe miratimet e njësisë do të lëshohen dhe do të zgjaten në një periudhë vlefshmërie prej 12 muajsh".

Neni 2

Neni 11, amendamentohet si në vazhdim:

Paragrafi 1, zëvendësohet me:

"Miratimet e njësisë do të vlejnjë për një periudhë fillestare prej 12 muajsh. Vlefshmëria e miratimeve të tilla do të zgjatet për 12 muajt pasues, nëse ofruesi i shërbimit të navigacionit ajror demonstron se:".

Neni 3

Miratimet e gradimit dhe miratimet e njësisë të lëshuara apo të ripërtëritura para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje do të mbesin të vlefshme deri në datën e tyre të vlefshmërisë.

Neni 4

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 1 dhjetor 2010.

Dritan Gjonbalaj
Drejtor i Përgjithshëm